



**BASHKIA ROSKOVEC**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**OBJEKTI :**  
**RELACION TEKNIK**  
**REHABILITIMI I QENDRES SE FSHATIT STRUM**

Miratohet :  
Kryetari i Bashkisë  
**Majlinda Bufi**

### **Problematika të gjendjes ekzistuese:**

Fshati Strum është pjesë e Njesisë Administrative Strum, Bashkia Roskovec, ka nje popullsi rreth 2500 banorë , fshati Strumë aktualisht nuk ka nje qendër apo një park lojrash për femijë, lulishte. Aktualisht fshati Strumë është një fshat ku aktiviteti parësor është bujqësia, për vetë mundësitë që i ofron natyra. Kalimi i përroit përgjatë gjithë gjatësisë së këtij fshati ofron pamje panoramike, hapësira të gjelbërta natyrore të cilat impaktin më të madh e kanë pikërisht në qendër të këtij fshati.

Zona ku do te realizohet projekti zhvillimor i qendrës së fshatit është zona më e populluar e fshatit. Aty ndodhen shërbimet kryesore si qendra shendetësore, dyqane ushqimore, bare, etj. Mungesa e trotuarit sjell edhe problematika ne kalimin e këmbësorëve ,sidomos të fëmijëve të cilët shkojnë ne shkollën aty pranë. Gjithashtu ndriçimi i qendrës është inekzistent, çka vështirëson qarkullimin e automjeteve dhe banorëve, përgjatë orëve të vona.

### **Qëllimi i rehabilitimit:**

Qëllimi i këtij projekti është sistemimi i qendrës së fshatit duke e kthyer në një vend shkollës për banorët dhe për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike e bujqësore, duke sistemuar edhe infrastrukturën rrugore, vendosja e stolave në disa pika kryesore si dhe krijimi i lulishteve do t'u mundësojë banorëve që jo vetëm të lëvizin më lirshëm e më të sigurt, por dhe të kenë një shëtitore të shfrytëzueshme dhe si ambient atraktiv e shlodhës.

### **Parashikime në projekt:**

Projekti parashikon sistemimin e qendrës së këtij fshati, duke mundësuar integrimin e ambienteve natyrore dhe atyre urbane. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet krijimit të hapësirave rekreative, të gjelbëra, shëtitores dhe asfaltimit të infrastrukturës lokale

Në hapësirat rekreative do të përfshihet ndërtimi i një këndi lojërash me lodra dhe hapësira të dedikuara për fëmijë. Pranë tyre do të pozicionohen stola të përmasave të ndryshme, pemë me

lartësi të madhe për të siguruar hijezim gjatë periudhës së verës.

Janë parashikuar të asfaltohen dhe zgjerohet rruga kryesore me një gjerësi prej 2 m dhe një gjatësi prej 100 m. Me rëndësi është krijimi i një stacioni për qëndrimin e urbanëve dhe furgonave për transportin e qytetarëve.

Në një pjesë të dytë të parkut, larg hapësirës shlodhëse është pozicionuar parkimi me 4 vende për automjete për të mos lejuar depërtimin e zhurmave dhe fluksit të njerëzve.

Gjithashtu është parashikuar sistemimi dhe asfaltimi i territorit të ambulancës ku është pozicionuar edhe vend qëndrimi i ambulancës në raste emergjence. Ndarja midis kësaj godine dhe parkut të lojërave është realizuar me një barrierë të gjelbër, për të eliminuar ndotjen akustike dhe vizuale.

Shëtitorja do të shtrohet me trotuar me gjerësi të ndryshueshme përgjatë aksit të kalimit. Ajo shtrihet në të gjithë pjesën perëndimore dhe jugore të sheshit, ku në gjysmën e saj është parashikuar një akses i limituar autovegurash, në funksion të biznesit ekzistues. Mobilimi urban i saj përfshin vendosjen e pemëve në trotuar, ndriçimit me shtylla me H=7m, stolave betonarme me gjatësi të ndryshme dhe koshave për hedhjen mbeturinave.

### **Specifikime teknike:**

**Rruga** do të ndërtohet me këto shtresa :

- Binder 5cm
- Asfaltobeton 3 cm
- çakëll 20 cm
- stabilizant 5 cm
- Nenshtrese ekzistuese

**Trotuari** do të ndërtohet me këto shtresa :

- shtrese stabilizanti t = 5cm
- shtresë betoni M-150, 6 cm
- pllaka granili 6cm
- tokë natyrale

Kuneta e betonit do të realizohet me beton M-200 , me puseta shimbledhëse 40 x 40 cm. Nën të do të vendoset tub d=315mm i brinjëzuar HDPE SN 8.

Ndriçuesit do të pozicionohen përgjatë shëtitorës dhe këndit të lojërave , me H = 7m , me ndriçues monitonale SPA-T 150W.

**Hartoi : Ark. Kejsi Voli**

